

## RELACION

### MBI PROJEKTAKTIN NORMATIV ADMINISTRATIV:

#### RREGULLORE “PROCEDURA E ANKIMIT NË KOMISIONIN KOMBËTAR RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA, PËR NJË TË LICENSUAR” DOKUMENT PËR KËSHILLIM PUBLIK”

### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT ADMINISTRATIV DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN

Në nenin 30 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” i ndryshuar (**ligji nr. 8102**), lidhur me ankesat përcaktohet e drejta e çdo personi të interesuar për t’i dërguar Komisionit një ankesë me shkrim për një të licensuar, për të cilin mendon se ka shkelur dispozitat e ligjit nr. 8102, apo të ndonjë urdhëri, rregulli, license apo udhëzimi të nxjerrë sipas këtij ligji.

Referuar pikës 3 të nenit 2 të ligjit nr. 8102, me termin “Komision” nënkuptohet Komisioni Kombëtar i Rregullimit që udhëheq Entin Rregullator të Ujit (ERRU). Në interpretim të këtij përcaktimi, si dhe të nenit 15 të këtij ligji sipas të cilit “personat fizikë apo juridikë, që merren me veprimtarinë e grumbullimit, të shpërndarjes, largimit dhe trajtimit të ujit, për përfitim publik, duhet të pajisen me licensë nga ERRU-ja”, neni 30 ngarkon Komisionin me kompetencën e shqyrtimit të një ankimi të adresuar për një të licensuar nga ERRU, nga cilido person që ka një interes të caktuar lidhur me këto shërbime të ofruara sipas ligjit nr. 8102 dhe aktet nënligjore dhe rregullatorë të nxjerra sipas këtij ligji.

Neni 30 i ligjit nr. 8102, përcakton që procedura e ankimit bëhet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative. Kjo nënkupton që procedura që duhet të zbatohet nga palët, ankimuesi si person i interesuar dhe Komisioni si organi administrativ që mbart detyrimin ligjor të shqyrtimit të ankesës, si dhe i licensuari si subjekti ndaj të cilit drejtohet ankesa, duhet të bazohet në përcaktimet e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative si ligj i përgjithshëm.

Qëllimi i këtij projektakti : Rregullore “Procedura e ankimit në Komisionin Kombëtar Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, për një të licensuar” (**Projektakti**) është vendosja e një kuadri rregullator për zbatimin e së drejtës që ka çdo person i interesuar për t’i dërguar Komisionit Kombëtar Rregullator të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura që udhëheq Entin Rregullator të Ujit (ERRU), një ankesë me shkrim për një të licensuar, për të cilin mendon se ka shkelur dispozitat e ligjit nr. 8102, datë 28. 3. 1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” të ndryshuar apo të ndonjë urdhëri, rregulli, license apo udhëzimi të nxjerrë sipas këtij ligji.

Objektivi kryesor i projektaktit është informimi i cilësdo palë të interesuar, që në mënyrë transparente, të njohë dhe zbatojë procedurën që do të zbatohet nga organi administrativ kompetent, për ushtrimin e një të drejte themelore siç është e drejta e ankimit.

Një objektiv tjetër shumë i rëndësishëm është edhe vendosja e rregullave sa më të qarta dhe të kuptueshme nga personat e interesuar, mbi bazën e përcaktimeve ligjore të parashikuara në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i ndryshuar, (*ligji nr. 44/2015*), për të garantuar mbrojtjen e interesave legjitime të tyre si dhe për të shmangur sa më shumë interpretime të gabuara dhe të pabazuar ligjërisht.

Gjithashtu një objektiv që është synuar të arrihet nëpërmjet këtij projektakti është dhe ai i zbatimit të një procedure administrative për shqyrtimin e ankesave në përputhshmëri të plotë me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e konsumatorëve dhe të moskonkurrimit me procedurën që zbatohet sipas ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” të ndryshuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis konsumatorëve të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura, me shoqëritë tregtare të Ujësjellës - Kanalizimeve si subjekte të ligjit me statusin e të licencuarit nga ERRU sipas ligjit nr. 8102.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME POLITIKAT E KËSHILLIT TË MINISTRAVE, OBJEKTIVAT RREGULLATORE DHE REKOMANDIMET E KUVENDIT**

Projektakti i propozuar për miratim nga Komisioni, është në përputhje të plotë me politikat e zhvillimit sektorial të Këshillit të Ministrave, objektivat rregullatorë të ERRU dhe rekomandimeve të Kuvendit sipas Rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Entit rregullator të Ujit (ERRU) për vitin 2017.

## **III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË**

Nxjerrja e projektaktit bazohet në kompetencën e ERRU të përcaktuar në nenin 29 të ligjit nr. 8102 sipas të cilit ERRU miraton rregullat procedurale që, do të përdorë për kryerjen e funksioneve që i jep ky ligj. Këto rregulla përmbajnë:

- a) ...(ii) skedimin e aplikimeve, ankesave dhe kërkesave të tjera që i janë dorëzuar komisionit....

Si dhe kompetencën e Komisionit të përcaktuar në pikën (1) i) për të nxjerrë rregulla për të ndihmuar në ushtrimin e kompetencave dhe funksioneve të parashikuara në këtë ligj.

Ligji nr. 8102 në nenin 30 të tij përcakton adresimin e një ankese nga çdo person i interesuar në Komision, kur mendon se një i licensuar ka shkelur dispozitat e këtij ligji, apo të ndonjë urdhëri, rregulli, license apo udhëzimi të nxjerrë në zbatim të ligjit nr. 8102, dhe për kryerjen e procedurës së ankimit në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

Procedura administrative për paraqitjen e ankesës në Komision dhe shqyrtimin e ankesës nga Komisioni bazohet tërësisht në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

## **IV. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BE-së (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)**

Në drejtim të përputhshmërisë me Acquis të BE-së, projektakti nuk gjen përputhshmëri të drejtpërdrejtë pasi legjislacioni i BE-së nuk përmban ndonjë Direktivë specifike për këtë qëllim por gjen përputhshmëri në frymë dhe në konsideratat që Komisioni merr parasysh për zgjidhjen e ankesës për të qenë e bazuar në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, kuadrin ligjor dhe nënligjor vendor dhe kuadrin rregullator sektorial.

## **V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKAKTIT**

Projektakti nga pikëpamja formale e përmbajtjes është strukturuar duke treguar vëmendje në zbatimin e rregullave të përgjithshme të teknikës legjislative si dhe në ndërtimin e një akti administrativ normativ (Rregullore) sa më të kuptueshme dhe të qartë duke patur parasysh karakterin e tij si një bashkësi rregullash administrative procedurale të bazuar plotësisht në ligjin nr. 44/2015. Projekt akti është ndarë në 5 (pesë) kapituj të emërtuar:

Kreu I “Të përgjithshme”

Kreu II “Parime të përgjithshme dhe kompetenca”

Kreu III “Garantimi i paanshmërisë”

Kreu IV “Procedura administrative dhe afatet”

Kreu V “Dispozita të fundme”

Në kreun e I-rë janë përfshirë qëllimi i rregullores, objekti, baza ligjore ku janë mbështetur dispozitat në përmbajtje të rregullores, përkufizime dhe fusha e zbatimit.

Në kreun e II-të janë përfshirë parimet mbi të cilat mbështetet zbatimi i rregullave procedurale nga ana e Komisionit si organi kompetent për shqyrtimin e ankesës. Parimet e vendosura janë në përputhje me parimet e përcaktuara në ligjin nr. 44/2015 për veprimtarinë e organeve administrative. Gjithashtu në kreun II është përfshirë edhe përcaktimi i juridiksionit dhe kompetencës së Komisionit për zbatimin e procedurës administrative për shqyrtimin e ankesës. Në kreun e III-t është përfshirë rregullimi i garantimit të paanshmërisë së Komisionit në shqyrtimin e ankimit.

Në kreun e IV-të janë përfshirë rregullat për zbatimin e procedurës administrative duke përcaktuar rregullat mbi veprimet administrative për paraqitjen e ankimit, regjistrimin e ankimit nga ERRU, fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e ankimit, vendimet e ndërmjetme, pajtimi i palëve, afatet dhe rivendosjen në afate, përfundimin e procedurës administrative, hetimi administrativ dhe pasojat juridike të vendimit përfundimtar.

Në kreun e V-të janë përcaktuar dispozitat e fundme, rregullimin për çështjet e parregulluara dhe hyrja në fuqi.

## **VI. RAPORTI I VLERËSIMIT FINANCIAR**

Projektakti nuk sjell asnjë pasojë financiare shtesë në buxhetin e ERRU pasi veprimet administrative që do të kryhen në përputhje me procedurën administrative për shqyrtimin e ankesave do të kryhen në kuadër të veprimtarisë së administratës së ERRU sipas strukturës dhe organikës dhe Komisionit, pa asnjë kosto shtesë.

## **VII. STRUKTURAT QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKAKTIT**

Procedura për regjistrimin e ankimit, përpunimin dhe administrimin shkresor të dokumentacionit dhe provave të paraqitura do të kryhen nga drejtoria e shërbimeve të brendshme për veprimet lidhur me protokoll-arkivën, drejtoria juridike dhe e konsumatorit për administrimin dhe përpunimin shkresor të dokumentacionit, provave, njoftimeve etj., të këtij karakteri mbështetës administrativ, si dhe shqyrtimi i ankimit dhe vendimmarrja do të kryhet nga Komisioni.